

**AKTI I THEMELIMIT TE  
SHOQËRISË ME PERGJGJËSI TË KUFIZUAR  
“ESSA ENERGY” SH.P.K**

Themeluesi i Shoqerise qe nenshkruan me poshte:

- **SARA HYLVIU**, e bija e Rudin-it, lindur me date 28/05/2002 ne ITA, banuese ne Kavaje, e identifikuar me karte identiteti nr.personal **K255280591**

**Kreu I**

**Te Dhenat mbi Shoqerin Tregtare**

**Neni 1**

Ne Kavaje, sot, me date **17/Prill/2024**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe te plote, ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, vendosi te hartoje kete statut per funksionimin e shoqerise tregtare me perjegjesi te kufizuar; **“ESSA ENERGY” SH.P.K**, me Administratore te vetem **SARA HYLVIU**.

Ne baze te kushteve qe vijojne:

**Adresa e shoqerise:** Rruga “Mehmet Bejtaga”, Zone Kadastrale 8551, Nr. Pasurie 8/427 , Bashkia Kavaje.

**Objekti i Veprimtarise:** Stacione per prodhim energjie, paneleve fotovoltaike, panele diellor etj

**Selia e Shoqerise:** Rruga “Mehmet Bejtaga”, Zone Kadastrale 8551, Nr. Pasurie 8/427 , Bashkia Kavaje

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqeria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Stacione per prodhim energjie, paneleve fotovoltaike, panele diellor etj, Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te cdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 te Ligjit nr.990 1 ,dt.14.04-08).

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pa percaktuar:

**Neni 4**

**Selia**



- Rruga “Mehmet Bejtaga”, Zone Kadastrale 8551, Nr. Pasurie 8/427 , Bashkia Kavaje.
- Adresa e fakes së internetit të shoqërisë është (nëse ka):
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

**Kreu II**

**Kapitali**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

- Kapitali themeltar fillestari i shoqërisë është **100.000** (njeqind mijë) Leke, (sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtme:
- Ortaket themelues janë **SARA HYLVIU**, zoterues i l (një) kuote me vlerë të përgjithshme **100.000** (njeqind mijë) Leke, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë kontributi e ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**

**Transferimi i kapitalit**

- Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - shitblerjes;
  - trashëgimisë;
  - dhurimit;
  - çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**

**Organi Vendimmarres**

- Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj.
- Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, mund te bej perfaqsimin dhe me videocall.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

**Neni 9**

**Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme**

- Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**Neni 10**

**Kuorumi**



- Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### Neni 11

#### Marrja e vendimeve

- Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje tjera si:
  - përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - përcaktimin e shpërblimeve;
  - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### Neni 12

#### Përjashtimi nga e drejta e votës

- Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes në se asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13

### Administrimi

- Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5-vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje, emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:  
(emer, mbiemri, adresa):

dhe specimenët e nënshkrimit:

- SARA HYLVIU**, e bija e Rudin-it, lindur me date 28/05/2002 ne ITA, banuese ne Kavaje, e identifikuar me karte identiteti nr.personal **K25528059I**

### Neni 14

### Kompetencat e Administratorëve

- Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - Përfaqësojnë shoqerinë tregtare;
  - Kujdesen përmblajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpëra asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - Kryejnë regjistimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmblajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
  - Raportojnë përpëra asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmblajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
  - Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:
  - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet i shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5-(pese) % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



- c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5-(pese) % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- d) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqérinë.
- e) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqérinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 15

#### Pergjegjesite e Administratorit

- Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

  - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mëdus;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

- Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.
- Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Kreu IV

##### Viti finanziar-ekspertet

###### Neni 16

- Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

###### Neni 17

##### Ekspertet

- Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithhevjetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financier vjetor si dhe per ate per kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Kreu V

##### Prishja – riorganizimi i shoqërisë

###### Neni 18

##### Prishja dhe likuidimi

- Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe:
  - kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - me vendim të Asamblese se Ortakeve;
  - me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
  - me vendim të gjykatës;

- Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".
- Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e astësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### Neni 19

#### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

### Neni 20

#### Baza Ligjore

- Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqipërise.

### Neni 21

#### Mosmarrëveshjet

- Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKET**

#### **E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"ESSA ENERGY" SH.P.K**

**SARA HYLVIU**